




FAKTI

2022 Sanitacioni dhe ujërat nëntokësore

Dita Botërore e Tualetit 2022: Të bëjmë të padukshmen të dukshme



Cila është tema e Ditës Botërore të Tualetit në vitin 2022?

Tema e Ditës Botërore të Tualetit për vitin 2022 është „Sanitacioni dhe ujërat nëntokësore”.

Për çfarë është fushata e Ditës Botërore të Tualetit për vitin 2022 ?

Titulli i fushatës për Ditën Botërore të Tualetit 2022 është „Të bëjmë të padukshmen të dukshme».

Duke e bërë të padukshmen të dukshme

Ne po përballemi me një krizë globale sanitare. Sot, 3.6 miliardë njerëz ende jetojnë me tualete me cilësi të dobët që shkatërrojnë shëndetin e tyre dhe që e ndotin mjedisin. Çdo ditë, më shumë se 800 fëmijë vdesin nga diarreja si pasojë e ujit të pasigurt, kushteve sanitare dhe higjenes së dobët.

Këtë vit, Dita Botërore e Tualetit fokusohet në ndikimin e krizës sanitare ndaj ujërave nëntokësore.

Sistemet joadekuate sanitare shpërndajnë mbetjet njerëzore në lumenj, liqene dhe tokë, duke ndotur kështu burimet ujore nëntokësore. Megjithatë, duket sikur ky problem është i padukshëm. I padukshëm sepse ndodh nën tokë. I padukshëm sepse ndodh në komunitetet më të varfra dhe më të marginalizuara.

Uji nëntokësor është burimi ynë më i bollshëm i ujit të freskët. Ai mundëson furnizimin me ujë të pijshëm, funksionimin e sistemeve sanitare, bujqësinë, industrinë dhe ekosistemet. Me përkeqësimin e ndryshimeve klimatike dhe me rritjen e popullsisë, ujërat nëntokësore janë jetike për mbijetesën tonë.

Menaxhimi i sigurt i sanitacionit i mbron ujërat nëntokësore nga ndotja nga mbetjet njerëzore. Qëllimi 6.2 për Zhvillim të Qëndrueshëm është premtimi i botës për të ofruar tualete të sigurt për të gjithë deri në vitin 2030. Kjo do të thotë që të gjithë të kenë akses në një tualet të lidhur me një sistem sanitar që mënjanon dhe trajton në mënyrë efektive mbetjet njerëzore. Por ne jemi shumë larg realizimit të këtij qëllimi.

Ne duhet të punojmë mesatarisht katër herë më shpejt për të siguruar që të gjithë të kenë një tualet të sigurt deri në vitin 2030. Lidhja midis ujërave sanitare dhe nëntokësore nuk mund të anashkalohej. Koha po kalon. Ne duhet ta bëjmë të padukshmen të dukshme.

Cilat janë mesazhet kryesore?

- 1. Sanitacioni i sigurt i mbron ujërat nëntokësore.** Tualetet që janë instaluar dhe lidhur siç duhet me sistemet sanitare të menaxhuara në mënyrë të sigurtë mbledhin, trajtojnë dhe asgjësojnë mbetjet njerëzore dhe ndihmojnë në parandalimin e përhapjes së mbetjeve njerëzore në ujërat nëntokësore.
- 2. Sanitacioni duhet tu rezistojë ndryshimeve klimatike.** Tualetet dhe sistemet sanitare duhet të ndërtohen ose përshtaten për tu përballuar ngjarjeve ekstreme të motit, në mënyrë që shërbimet të funksionojnë pa ndërprerje dhe kështu të mbrohen ujërat nëntokësore.
- 3. Masat sanitare janë urgjente.** Ne jemi vërtetë shumë larg sigurimit të tualeteve të sigurt për të gjithë deri në vitin 2030. Këto tetë vite që kanë mbetur, bota duhet të punojë katër herë më shpejt për të përmbushur këtë premtim.

Çfarë është kriza globale sanitare?

Pothuajse gjysma e popullsisë së botës ende jeton pa një „tualet të sigurt”. „Tualeti i sigurt» është shkurtësë për një sistem sanitar të menaxhuar në mënyrë të sigurt, që nënkupton një tualet që nuk ndahet me familje të tjera, ose që trajton ose mënjanon mbetjet njerëzore në vend, i ruan ato në mënyrë të sigurt për t'u zbratur dhe trajtuar jashtë vendit, ose që lidhet me kanalizim funksional ose me stacion për pastrim.

Njerëzit që jetojnë pa akses në sistemet e kanalizimeve të menaxhuara në mënyrë të sigurt përdorin objekte të përbashkëta ose të tilla që nuk i mënjanojnë në mënyrë të sigurt mbetjet njerëzore. Pothuajse 500 milionë njerëz defekojnë jashtë (defekim në mjedis të hapur) dhe 3.6 miliardë njerëz - gati gjysma e popullsisë globale - nuk janë të lidhur me sistemet sanitare të menaxhuara në mënyrë të sigurt, që i lënë mbeturinat njerëzore të patrajuara dhe ndotin komunitetet dhe ujën që përdoret për pije, higjienë, rekreacion dhe prodhim të ushqimit.

Zonat urbane dhe rurale përballen me sfida të ndryshme. Në zonat urbane me popullsi të dendur, gropat septike të vendosura afër pikave ujore që tërhiqin ujë nga një burim nëntokësor i cekët paraqesin rrezik serioz potencial për shëndetin. Në zonat rurale, kryesisht për shkak se ka më shumë hapësirë, tualetet dhe gropat septike mund të vendosen më lehtë në një distancë të sigurt nga pikat e ujit.

Kjo krizë ka një ndikim të thellë ndaj shëndetit publik, arritjeve arsimore, produktivitetit ekonomik dhe integritetit ekologjik. Më konkretisht, për gratë dhe vajzat në veçanti, indinjiteti, shqetësimi dhe rreziku nga mospasja qasje në sanitacion të menaxhuar në mënyrë të sigurt është një pengesë për pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqëri.

Çfarë është ujë nëntokësor?

Uji nëntokësor është uji që gjendet nën tokë në akuiferë, të cilët janë formacione gjeologjike të shkëmbinjve, rërës dhe zhavorrit që mbajnë ujë. Uji nëntokësor është deri tani burimi më i bollshëm i ujërave të ëmbla në nivel global, duke mbështetur sistemin e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve, prodhimin e ushqimit, proceset industriale dhe funksionimin e shëndetshëm të ekosistemeve. Në shumë zona, akuiferët janë afër sipërfaqes, duke i bërë ata veçanërisht të prekshëm ndaj ndotjes njerëzore nga toka dhe ujërat sipërfaqësore sipër.

Si ndikon sanitacioni joadekuat tek ujërat nëntokësore?

Përdorimi i ujërave nëntokësore për ujë të pijshëm është i rrezikuar për shkak të mënjanimin të pakontrolluar të fekaleve njerëzore, sidomos në zonat urbane me popullsi të dendur, dhe mungesa e sistemeve të qëndrueshme sanitare në qytetet me rritje të shpejtë të numrit të banorëve dhe zonat peri-urbane. Këto janë pesë fushat shqetësuese:

- 1. Tualetet me gropa dhe gropat septike:** Në një komunitet me popullsi të dendur, tualetet me gropa si dhe gropat septike të ndërtuara dhe të menaxhuara keq mund të shkaktojnë ndotje të konsiderueshme të shtresave ujore nëntokësore të cekëta dhe trupave ujqorë aty pranë. Kjo mund shkaktojë paraqitjen e sëmundjeve që burojnë nga uji i kontaminuar ngarkim të lartë e të dëmshëm të ujit të rezervave dhe liqeneve me materie ushqyese.
- 2. Hedhja e llumit fekal në deponi:** Aty ku mbetjet njerëzore merren nga tualetet me gropa dhe gropat septike dhe hidhen me mbetje të tjera të ngurta në deponi pa shtresa të papërshkueshme dhe pa menaxhim të mirë të ujërave të zeza, mundësia e ndotjes së ujërave nëntokësore është e lartë.
- 3. Ujitja me ujëra të zeza të patrajtuara:** Fermat dhe qeveritë komunale për ujitje ndonjëherë përdorin ujëra të zeza të patrajtuara. Kjo paraqet një rrezik të madh shëndetësor për fermerët dhe konsumatorët e perimeve me gjethe të ujitura me këto ujëra të zeza të patrajtuara, si dhe kur praktikohet pranë puseve publike të pambrojtura të ujit dhe vendbanimeve njerëzore.
- 4. Derdhja e ujërave të zeza:** Në qytetet ku kanalizimet përdoren për mënjanimin e ujërave të zeza, aranzhmanet për mënjanimin dhe ripërdorimin e ujërave të zeza shpesh janë të pamjaftueshme, me rreziqe të konsiderueshme të ndotjes së akuiferëve nëntokësorë ose lumenjve ku derdhen ujërat e zeza.
- 5. Ndikimet në ndryshimet klimatike:** Në zonat me reshje intensive, tualetet, gropat septike dhe kanalizimet e hapura mund të vërshojnë, duke i përhapur kështu mbetjet njerëzore në tokë dhe në ujërat sipërfaqësore. Për dallim nga kjo, në zonat më thatësi të madhe, sistemet sanitare si tualetet mund të bëhen të papërdorshme, duke i detyruar kështu njerëzit të defekojnë jashtë.

Si i mbrojnë ujërat nëntokësore zgjidhjet sanitare?

Sanitacioni i menaxhuar në mënyrë të sigurt dhe i instaluar në mënyrën e duhur i mbron njerëzit dhe ujërat nëntokësore nga patogjenët në mbetjet fekale. Një sistem sanitar i sigurt dhe i qëndrueshëm fillon me një tualet që mbledh me efikasitet mbetjet njerëzore në një mjedis të sigurt, të aksesueshëm dhe dinjitoz. Këto mbetje më pas ruhen në një rezervuar, i cili mund të trajtohet në vend ku mbetjet e lëngshme depërtojnë në tokë dhe lëndët e ngurta mund të zbrazen më vonë nga shërbimi i grumbullimit. Ose, përmes kanalizimit transportohen deri tek një stacion pastrimi dhe më pas mënjanohet ose ripërdoret në mënyrë të sigurt. Ripërdorimi i sigurt i mbetjeve njerëzore të trajtuara mund të kufizojë emetimet e gazeve serrë për prodhimin e energjisë dhe t'i sigurojë bujqësisë një burim të besueshëm uji dhe të materieve ushqyese.

Sistemet e qëndrueshme të kanalizimeve duhet të jenë në gjendje të përballojnë përmytjet më të shpeshta, thatësitat, ndryshimet në disponueshmërinë e ujit dhe ngritjen e nivelit të detit të shkaktuar nga ndryshimet klimatike, në mënyrë që shërbimet të funksionojnë pa ndërprerje dhe të mbrohen ujërat nëntokësore. Në zonat ku ka mungesë uji dhe disponueshmëri të reduktuar të ujërave nëntokësore, ujërat e zeza të trajtuara mund të përdoren për të rimbushur akuiferët dhe për të rimbushur rezervat e ujërave nëntokësore.

Zonat mbrojtëse të ujërave nëntokësore janë jetike, si pjesë e një qasjeje të integruar specifike për të siguruar që sistemet sanitare, planifikimi i përdorimit të tokës dhe nxjerrja e ujit të mos ndikojnë negativisht në cilësinë dhe sasinë e burimeve ujore nëntokësore, veçanërisht në zonat ku akuiferët janë afër sipërfaqes.

Pse duhet të kujdesemi për ndotjen e ujërave nëntokësore?

Riparimi i ndotjes së ujërave nëntokësore të shkaktuara nga njeriu është shpesh një proces i gjatë dhe i vështirë. Kjo rrit kostot e trajtimit të ujërave nëntokësore, dhe ndonjëherë edhe ndalon përdorimin e tyre. Hulumtimi, mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i ujërave nëntokësore do të jenë thelbësorë për mbijetesën dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe plotësimin e nevojave të një popullsie në rritje.

Pse është e rëndësishme zgjidhja e krizës sanitare?

Qasja në shërbime sanitare të menaxhuara në mënyrë të sigurt, të kombinuara me shërbimet e ujit të pijshëm të menaxhuar në mënyrë të sigurt dhe objektet dhe sjelljet e mira higjienike, është themeli i shëndetit publik dhe për këtë arsye edhe qenësor për realizimin e të gjitha të drejtave të tjera të njeriut. Tualetet mundësojnë përmirësime në shëndetësi, barazi gjinore, arsim, ekonomi dhe mjedis jetësor. Për gratë dhe vajzat, tualetet në shtëpi, në shkollë dhe në punë i ndihmojnë ato të përbushin potencialin e tyre dhe të luajnë rolin e tyre të plotë në shoqëri, siomos gjatë menstruacioneve dhe shtatzënisë.

Çfarë mund të bëjnë vendimmarrësit në lidhje me kushtet sanitare dhe lidhjen e tyre me ujërat nëntokësore?

Lidhja mes ujërave nëntokësore dhe ujërave të zeza ka qenë gjithmonë shumë e rëndësishme, por jo plotësisht e njohur. Ne duhet t'i mbrojmë ujërat nëntokësore nga ndotja dhe t'i përdorim ato në mënyrë të qëndrueshme, duke balancuar nevojat e njerëzve dhe planetit.

Roli jetik i ujërave nëntokësore në sistemet e ujit dhe sanitacion duhet të reflektohet në politikëbërje. Sipas Kornizës Globale për Përshejtimin e SDG 6, veçanërisht në fushat e qeverisjes, ndërtimit të kapaciteteve, të dhënave dhe informacionit, lidhja midis ujërave nëntokësore dhe kanalizimeve duhet të forcohet përmes politikës gjithëpërfshirëse dhe zbatimit të koordinuar të saj. Kjo mund të arrihet me rritjen e bashkëpunimit mes specialistëve të ujërave nëntokësore dhe sanitare, politikëbërësve dhe praktikuesve.

Veprim për kushte sanitare – pse duhet bërë urgjentisht?

Objektivi 6 për Zhvillim të Qëndrueshëm është të sigurojë disponueshmërinë dhe menaxhimin e qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve për të gjithë deri në vitin 2030.

Qëllimi 6.2 i SDG nënkupton arritjen e qasjes në sanitacion adekuat dhe të drejtë për të gjithë dhe përfundimi i defekimit në mjedis të hapur, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grave dhe vajzave dhe atyre në situata të cenueshme».

Për momentin, bota është shumë larg rrugës drejt përmbushjes së SDG 6.2. Sot, 3.6 miliardë njerëz ende jetojnë pa shërbime sanitare të menaxhuara në mënyrë të sigurt.

Të dhënat më të fundit tregojnë se gjatë tetë viteve të ardhshme qeveritë duhet të punojnë katër herë më shpejt për të përmbushur premtimin e SDG 6.2. UN-Water inkurajon botën për të ndërmarrë veprime përmes Kornizës Globale të Përshejtimin të SDG 6 dhe akceleratorëve të veçantë për kushtet sanitare të shënuar në raportin për sanimin e gjendjes në botë.

Fushata e Ditës Botërore të Tualetit 2022 u bën thirrje vendimmarrësve dhe politikëbërësve të përshpejtojnë përparimin sa i përket kushteve sanitare dhe të sigurojnë që lidhja midis ujërave të zeza dhe ujërave nëntokësore të pasqyrohet në legjislacion dhe udhëzimet përkatëse në të gjitha nivelet administrative, nga ato ndërkombëtare dhe kombëtare, si dhe ato lokale.

Links:

#WorldToiletDay

World Toilet Day 2022 website:

www.worldtoiletday.org

UN World Water Development Report 2022:

www.unwater.org/publication_categories/world-water-development-report

WHO/0e (JMP):

washdata.org

UNICEF and WHO State of the World's Sanitation report:

www.unicef.org/reports/state-worlds-sanitation

SDG 6 Data Portal:

www.sdg6data.org

SDG 6 Global Acceleration Framework:

www.unwater.org/publications/the-sdg-6-global-acceleration-framework

UN 2023 Water Conference

sdgs.un.org/conferences/water2023

UN-Water Summit on Groundwater 2022:

www.groundwater-summit.org

United Nations website:

www.un.org

UN-Water website:

www.unwater.org